



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 802/1 Prot.

Tiranë, më 26 . 05 . 2026

V E N D I M

Nr. 118, datë 26 . 05 . 2026

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 108 Regj., datë 23.04.2026, të F. B, kundër Operatorit të Shpërdarjes së Energjisë Elektrike sha (OSHEE) Durrës, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Subjekti ankues, F. B, pretendon se është diskriminuar nga ana e Operatorit të Shpërdarjes së Energjisë Elektrike sha (OSHEE) Durrës.

Lidhur me pretendimin për diskriminim nga ana e OSHEE sha Durrës, shpjegon se ka qenë i punësuar pranë këtij Institucioni nga data 08.04.2021 deri më datë 30.09.2024.

Ankuesit i është komunikuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Durrës se kishte një debi prej 1.276.758 lekësh, e cila ishte si pasojë e punësimit të tij, pasi ai është trajtuar me pagesë invaliditeti (KMCAP), duke qenë i punësuar njëkohësisht me kohë të plotë. Z. B, pretendon se nuk është kontaktuar asnjëherë dhe nuk i është dhënë informacion nga ansjëri prej institucioneve për këtë fakt.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

Ankuesi ka dhënë dorëheqjen nga puna më datë 03.12.2024, dhe nga ai moment e deri më sot i mbahet çdo muaj nga pensioni i invaliditetit një vlerë prej 9.461 lekësh, debi e cila do të zgjasë për 12 (dymbëdhjetë) vite, deri në shlyerjen e plotë të saj.

Ankuesi kërkon nga Komisioneri kërkon zgjidhjen e problematikës së tij.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7 të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, konstatohet se:

- Ankuesi me Vendimin e KMCAP³ Durrës me nr. 2740 prot., datë 28.10.2009 është vlerësuar me grup invaliditeti të plotë, Grupi I, me të drejtë për pagesë invaliditeti, duke filluar që nga data 28.10.2009 deri “përgjithmonë”.
- Ankuesi ka qenë i punësuar për periudhat kohore 01.04.2017 – 30.06.2017 dhe 08.04.2021 – 30.09.2024.
- Me shkresën me nr. 2172 prot., datë 11.02.2025, DRSSH Durrës ka njoftuar ankuesin se: “...F. B është debitor në masën 1.276.758 lekë, për arsye se ka punuar me kohë të plotë në periudhën: 01.04.2017 – 30.06.2017 dhe 08.04.2021 – 30.09.2024. Do t'i mbahet 9.230 lekë në muaj për periudhën 01.12.2024 – 30.04.2036.”

³ Akronim për Komisionin Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë

- Konstatohet se është mbajtur një komunikim shkresor mes ankuesit dhe DRSSH Durrës: ankuesi ka kundërshtuar shkresën e njoftimit të detyrimit, të DRSSH Durrës, duke kërkuar shfuqizimin e saj, dhe nga ana tjetër Institucioni ka kthyer përgjigje, duke sqaruar ankuesin lidhur me arsyet ligjore se përse ai konsiderohej debitor nga DRSSH Durrës, duke cituar ndër të tjera se:

“Në mbështetje të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht nenit 35 dhe 36, të tij, si dhe në bazë të vendimit të KMCAP Durrës me nr. 2740 prot., datë 28.10.2009, ju jeni vlerësuar nga ky Komision me grup invaliditeti të plotë, Grupi I, me të drejtë pagese pensioni invaliditeti nga data 28.10.2009 deri përgjithmonë.

Në bazë të kontrollit të ushtruar në sistemin CMIS, datë 16.11.2024, rezultoi se ju keni qenë në marrëdhënie pune nga data 01.04.2017 – 30.06.2017 dhe 08.04.2021 – 30.09.2024.

Theksojmë se në kundërshtim me nenet 35 dhe 36, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ju keni punuar dhe keni përfituar pension si invalid i plotë.

Për këtë asrye jeni shpallur debitor në vlerën 1.276.758 lekë. Nga data 01.12.2024 – 30.04.2036, ju mbahet vlera 9.230 lekë te pensioni invaliditetit.”

Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e OSHEE sha Durrës, Komisioneri vëren se, ky pretendim është i pabazuar dhe nuk qëndron, pasi mbajtja e shumës prej 9.230 lekë në muaj nga pensioni i invaliditetit, në kuadër të debisë në vlerën 1.276.758, bëhet nga ana e DRSSH Durrës, dhe jo nga ish-punëdhënësi i tij.

Kjo për faktin se, të gjitha faktet e sqaruara e të pretenduara nga ankuesi, lidhen me veprimet e kryera nga ana e DRSSH Durrës, dhe se jo nga ish-punëdhënësi i tij.

OSHEE sha Durrës nuk ka asnjë lidhje të tërthortë apo të drejtpërdrejtë me shpalljen e tij si debitor nga ana e DRSSH Durrës.

Ankuesi nuk ka ngritur asnjë pretendim për sjellje apo veprime diskriminuese gjatë marrëdhënieve të punës nga ana e OSHEE sha Durrës, por në kërkimet e tij ka ngritur pretendimin për shfuqizimin e aktit që e ka shpallur debitor atë, akt ky i hartuar nga DRSSH Durrës, sipas kompetences lëndore e funksionale të këtij Institucioni.

Komisioneri vëren se, ankuesi pretendimet e tij për diskriminim nga ana e DRSSH Durrës për shkak të aftësisë së kufizuar të tij, me të njëjtat kërtime, shpjegime, argumente e fakte, i ka depozituar në kuadër të një ankese tjetër pranë Komisionerit, e cila është regjistruar me nr. 107 Regj., datë 23.04.2026, me pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e DRSSH Durrës.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/c, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse..... e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për

shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/c, dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 108 Regj., datë 23.04.2026, të subjektit ankues F. B, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONER

Genta Tafa (BUNGO)